

UNIVERSITETI I GJAKOVËS “FEHMI AGANI”

FAKULTETI I FILOLOGJISË

DEGA: GJUHË SHQIPE



PUNIM DIPLOME

Gjuha dhe leksiku në romanin: “Kronikë në gur” te Ismail Kadaresë

MENTORJA:

Dr. Rovena Vata

KANDIDATI:

Dorentina Dervishi

Gjakovë, 2018

UNIVERSITETI I GJAKOVËS “FEHMI AGANI”

FAKULTETI I FILOLOGJISË

DEGA: GJUHË SHQIPE



PUNIM DIPLOME

Gjuha dhe leksiku në romanin: “Kronikë në gur” te Ismail Kadaresë

Komisioni:

Kryetar _____

Anëtar _____

Anëtar _____

MENTORJA:

Dr. Rovena Vata

KANDIDATI:

Dorentina Dervishi

Gjakovë, 2018

Pasqyra e lëndës

HYRJE	4
1. Objekti dhe motivimi i temës	4
2. Metodologjia dhe metodat e punës.....	5
3. Baza teorike e punimit.....	5
4. Synimi i temës.....	6
KREU I: Leksiku i qytetit të Gjirokastrës	8
1.1 Shëmbylltura e qytetit	8
1.2 Shëmbylltura e Kronikës në gur.....	13
KREU II: Leksiku i emrave të personazheve dhe gjuha e qytetit në romanin <i>Kronikë në gur</i>	18
2.1 Leksiku i përdorimit të emrave të personazhave në roman.....	18
2.2 Leksiku dhe gjuha qytetit në romanin “Kronikë në gur”	23
PËRFUNDIME:	30
BIBLIOGRAFIA:	34

HYRJE

1. Objekti dhe motivimi i temës

Përmes kësaj teme diplome synojmë të bëjmë përshkrimin formal gjuhësor dhe interpretimin e një teknike letrare, që i takon fushës së leksikut, apo hapësirës së ndërmjetme mes gjuhësisë dhe letërsisë. Ne jemi të mendimit se gjuhësia ka një vend të rëndësishëm dhe madje të pazëvendësueshëm brenda studimeve letrare, e posacërisht në kohët e sotme, kur shprehet gjithnjë e më shumë dyshimi ndaj vlerësimit cilësues të letërsisë. Leksiku, si përmasë historike, dëshmon se për rreth 20 vjet shqipja u pasurua dukshëm në sasi dhe në cilësi.

Sipas studiueses Shefkije Islamaj “Përdorimi i gjuhës, siç dihet, parakupton komunikimin praktik gjuhësor dhe nënshtresën e saj mendimore, ndërsa si qëllim të vetin kryesor ka lehtësinë dhe arsyeshmërinë e komunikimit, jo gjithmonë është e lehtë të arrihet kjo nga bartësit e gjuhës”¹.

Formimi i imazheve të personazheve realizohet pikërisht përmes imagjinatës, e cila qëndron midis ndjeshmërisë dhe kuptimit. Thelbi i marrëdhënieve që krijohet midis këtyre dy anëve përcakton kufijtë e shtrirjes së imagjinatës sonë në ndërtimin e imazhit. Duke qenë të vetëdijshëm se personazhet e prozës së Kadaresë nuk pasqyrojnë një realitet konkret, pra diçka që ekziston, pra ato nuk janë objekt i perceptimit tonë, ne ndiejmë që edhe imazhi që krijojmë për to është i një lloji të veçantë².

Gjuha pasqyron një kombësi, ajo është pasqyra më e qartë e një kombësie dhe e kulturës së saj. Shkalla e pasurisë dhe e pastërtisë së gjuhës është një tregues i nivelit të kësaj kulture³.

Prirja për përdorimin e leksikut dialektor përbën një nga tiparet e gjuhës së Kadaresë, që shpreh përpjekjet e tij të frytshme për pasurimin dhe njësimin e mëtejshëm të gjuhës letrare shqipe si dhe përgjigjen që ai u dha, me punë e jo me fjalë, të gjithë atyre që e sulmuan në mënyrë asgjësuese shqipen letrare me mëtimin se ajo është një toskërishte letrare të krijuar në mënyrë të pamërituar dhe në kurriz të gegërishtes, me mëtimin se kjo toskërishte letrare është e mbyllur ndaj elementeve të gegërishtes⁴.

Filozofia, mendësia dhe traditat historike e kulturore të shqiptarëve, janë paraqitur në veprën e Kadaresë si shprehje e identitetit të fortë kombëtar, e vitalitetit të kulturës shpirtërore të popullit të

¹ Shefkije Islamaj, *Gjergj Fishta, gjuha dhe stili*, II, Prishtinë, 2012, f. 270.

² Floresha Dado, *Intuitë dhe vetëdije kritike*, Onufri, Tiranë, 2006, f. 141.

³ Eqrem Çabej, *Për pastërtinë e gjuhës*, në revistën: “Gjuha shqipe”, nr. 2/2008, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2008, f. 5.

⁴ Natasha Sotiri, *Fjalor i gjuhës së Ismail Kadaresë, shenjues i një gjendjeje të re të gjuhës shqipe*, në revistën: “Gjuha Shqipe”, nr. 2/2008, Prishtinë, 2008, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2008, f. 62.

vet dhe si faktor i qëndresës dhe i mbijetesës së tij. Krijues me një vetëdije të fortë kritike, Kadareja jo vetëm ka poetizuar vlerat shpirtërore të kombit të vet, por edhe ka fshikulluar traditat anakronike, mentalitetet e kohës, psikologjinë provinciale dhe konvencionet e jetës së shoqërisë shqiptare.

Vepra e Kadaresë është një kërkim i vazhdueshëm. Këto kërkime nxitën zhvillimin e prozës dhe të romanit refleksiv filozofik, jo në kuptimin e ngushtë të fjalës, por në kuptimin e romanit, indin e të cilit e formon mendimi për ngjarjet, filozofia e tyre dhe e historisë. Me Kadarenë erdhi në letërsinë shqipe një tip i ri proze, ku elementi narrativ, dhe aq më shumë ai deskriptiv, tërhiqet përpara forcës sugjestive të fjalës, të detajit e të figurës artistike⁵.

Gjuha e Kadaresë shquhet për veçori të shumta pothuaj në të gjitha fushat, në fjalësin, në fjalëformimin, në ndërtimin e togfjalëshave.

Shumica e studimeve leksikore, por duke përfshirë edhe gjuhën e përdorur në aspektin e studimit të saj kanë që qëllim jo vetëm thjesht t'i përshkruajnë veçoritë formale të tekstit si synim në vetvete, por edhe ta nxjerrin në pah domethënien e tyre funksionale për interpretimin e këtij teksti, siç është rasti ynë në lidhje me romanin e Ismail Kadaresë *Kroninë në gur*.

E kemi zgjedhur romanin për ta bërë objekt studimi në këtë temë diplome, sepse, ai bërë forma dominante letrare në shumicën e shoqërive, si në sasi leximi-konsumimi, apo në reagim dhe ndjeshmëri ndaj ndryshimeve kulturore⁶.

2. Metodologjia dhe metodat e punës

Për të realizuar këtë temë jemi ndalur në disa metoda, por si fillim po përmendim metodën biografike, psikologjike, sociologjike dhe ajo e krahasimit. Metoda e parë na ndihmon, që përmes të dhënave të jetës së autorit dhe formimit të tij, të zbulojmë se pse ka shkruar kaq shumë për gjuhën, për qytetin, për magjitë, për kulturën e qytetit të gurit dhe për femijërinë. Ndërsa metoda sociologjike na bën të ditur se përmes të dhënave dhe faktorëve historikë, kulturorë dhe social e kanë çuar Ismail Kadare në formimin veprës më të rëndësishme të rinisë së tij. Për të përfunduar këtë punim kemi përdorur herë një të një dhe herë tjetër metodë studimi. Duke përdorur herë një të një dhe herë tjetër kemi arritur në përfundimet e kësaj teme diplome.

3. Baza teorike e punimit

Si bazë kryesore për të realizuar këtë temë kemi shfrytëzuar romanin *Kronikë në gur* të Ismail Kadaresë, por edhe duke e gërshetuar me literaturë të bollshme shkencore. Monografite, studimet apo referimet janë jo të pakta.

⁵ Jorgo Bullo, *Ardhja e Kadaresë në prozën shqipe*, në revistën: "Filologji", nr. 5, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë, 1998, f. 11.

⁶ Lindita Tahiri, *Monologu personazhi dhe autori*, Kosova PEN Center, Prishtinë, 2006, f.10.

4. Synimi i temës

Në këtë analizë dhe studim të romanit *Kronikë në gur*, personazhi kryesisht kryen aktivitete fizike të lëvizjes, e percepton botën rreth tij si përvojë të të parit dhe të dëgjuarit, pa qenë në gjendje të ndikojë apo të veprojë në mjedisin që e rrethon, madje deri në masë të skajshme.

Mund të shohim se edhe gjatë përshkrimit të gjendjes emotive, gjuha e rrëfyesit pretendon objektivitet, me fjalët tëhuajsuere madje edhe në raport me emrin që shënon gjendje mendore.

Mund të themi se gjuha që i rrëfen ëndrrat dhe ndjesitë apo ligjërimin e brendshëm të këtij personazhi të romanit *Kronikë në gur*, pra gjendjet jo doemos plotësisht gjuhësore, shfaqet e distancuar, duke përdorur për shembull strukturën sipërfaqësore sintaktike si përgjasim të ligjërimin të brendshëm apo fillimin dhe mbarim e natyrshëm të ëndrrës, si transmetim besnik të përjetimit.

Mund të themi se përdorimi i formës dialektore në këtë rrëfim është në përputhje me përdorimin e elementeve të tjera gjuhësore që i shfrytëzon rrëfyesi për ta portretizuar personazhin. Rrëfyesi i shmanget kësaj forme atëherë kur transmetohen gjendje emotive dhe joverbale të ndërdijes të personazhit, dhe e përdor këtë formë në ligjeratën e drejtë të lirë të insertuar në përjetimet e personazhit. Rrëfyesi gradualisht, me zërin e vet e përshkruan ndërdijen e figurshme pothuaj në prag të artikulimit të saj verbal, që të alternojë hap pas hapi nga gjuha e vet në gjuhën e personazhit e të arrijë kulmin me artikulimin e botës së brendshme me vetë idiolektin e personazhit. Të rëndësishme parësore gjatë ngelin treguesit tipikë të fokalizimit të brendshëm të personazhit, në rradhë të parë kohezioni sintaktik, leksik, semantik dhe tingullor.

Më këto përzgjedhje gjuhësore, rrëfyesi e transmeton mesazhin se nuk pretendon njohuri të privilegjuar për gjendjen shpirtërore të personazhit, ai nuk thotë për shembull 'im atë ndjehej sikur', por e merr pozicionin e atij që vëren nga jashtë personazhit, duke e lënë personazhin fokalizues të plotë, edhe pse idiolekti është plotësisht i rrëfyesit. Toni lirik i përshkrimit të gjendjes shpirtërore nuk është shenjë e stilit simbolik a romantik të autorit, por shenjë e gjendjes së brendshme të personazhit, është teknikë për realizëm psikologjik. Rrëfyesi e arrin tonin ironik me shpërputhjen mes tensionit emotiv të personazhit dhe banalitetit të situatës-faktit që edhe pse femra e tij e idealizuar dhe e ëndërruar pas shumë kohe më në fund është njëqind për qind në dispozicion të tij, mendësisë kolektive totalitare. Megjithatë situata me tërë vrazhdësinë e saj e trondit personazhin, ai arrin ta shprehë me fjalë brendësinë e vet për herë të parë në roman, dhe ligjërimi me idiolektin e tij është shumë i fuqishëm brenda kornizave të përshkrimit figurativ të gjendjes së tij psikike.

Letërsia ndikon ndjeshëm gjuhësisht në mjedisin shoqëror. Lexuesi njihet përmes saj pasurinë e jashtëzakonshme sidomos në leksik dhe në sintaksë. Shkrimtarët, si mjeshtër të fjalës, me artin e tyre kanë dhënë ndihmesë të jashtëzakonshme për ta ngritur gjuhën tonë letrare në shkallën e gjuhëve më të përparuara, e kanë rritur ndjeshëm aftësinë dhe forcën e saj shprehëse. Gjuha e letërsisë artistike si një nga format e shfaqjes së gjuhës kombëtare, duhet të jetë më afër nxënësit

dhe ai të modelojë sa më shumë të folurit përmes kësaj gjuhe. Dihet tashmë sesi diferencohet në komunikim dikush që lexon dhe di të lexojë letërsi artistike⁷.

Përsosja e mëtejshme e shqipes sonë letrare, kërkon përpjekje të gjithë njerëzit e penës e në radhë të parë nga shkrimtarët tanë, që ta pasurojnë atë vazhdimisht jo vetëm me fjalë e me shprehje të bukura të të folmeve popullore të Veriut dhe të Jugut, por edhe me fjalë të krijuara sipas gjedheve të fjalëformimit të gjuhës shqipe⁸.

Mjetët e letërsisë, duke qenë një krijim i lirë shkrimtarësh, janë çdo pakti të detyrueshëm me lexuesit, janë të afta t'i rikthejmë mendimit dhe gjuhës atë frymë vetjake njerëzore, që humbi, më saktë u flijua, gjatë procesit dramatik, kur mendimi i besoi zbugosjen e tij dhe kjo e fundit, jo për faj të saj, nuk mundi ta mbante premtimin⁹.

Për lexuesin modern, dyshimi në mundësinë e rrëfimit, dyshimi se mund të flasësh, jo vetëm për dikë, por edhe si dikush tjetër do të ishte dyshim dhe krizë e skajshme e identitetit. Në një botë ku nëpërmjet teknologjisë virtualiteti është metafora supreme dhe dominante, funksioni kulturor dhe raporti i letërsisë me llojet e tjerë të gjuhës është i vetëkuptueshëm. Prezantimi i vetëdijes është dallim radikal nga gjuha e të folurit të përitshëm, dhe ndoshta i zbulon funksionet e gjuhës që më shumë i përshtaten qëllimit të fikcionit, por që në të folurit e përditshëm dominohen nga funksioni komunikativ¹⁰.

Në romanin *Kronikë në gur* edhe pse personazhet vazhdojnë të sillen si të gjithë njerëzit e tjerë e t'i ruajnë mendimet për vete, lexuesi e krijon ndjenjën se ka njohuri të dorës së parë për personazhin, se ka depërtuar në brendësinë e mendimeve të tij.

Shkrimtari është i lirë që, ashtu siç zgjedh gjininë, llojin, përmbajtjen, personazhet, të zgjedhë edhe gjuhën. Askush nuk ka të drejtë t'i thotë atij të jetë shrimtar mbarëkombëtar a shkrimtar dialektor¹¹.

Ismail Kadare i shfrytëzon disa teknika të monologut të brendshëm: monologun e cituar, dekronologjizimin asociativ, kujtesën e rrëfyer dhe monologun e kujtesës, herë si teknika të veçanta e herë të ndërlidhura me njëra-tjetrën. Tiparet gjuhësore të këtyre teknikave arrijnë një efekt të caktuar letrar dhe i kontribuojnë domethënies të përgjithshme të veprës. Konteksti rrëfyes i këtij romani i përshtatet natyrshëm teknikës të monologut të brendshëm në vetën e parë, meqë prezantohen shënimet personale të personazhit, të bazuara në rrëfimin e tij të kujtesës¹².

⁷ Valter Memisha, *Studime për fjalën shqipe II*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2015, f. 118.

⁸ Shaban Demiraj, *Roli i shkrimtarëve për zhvillimin e shqipes letrare në të kaluarën dhe sot*, në: "Letërsia shqip dhe gjuha letrare", Prishtinë, 1998, f. 28.

⁹ Ismail Kadare, *Mosmarrëveshja, mbi raportet e Shqipërisë me vetveten*, Onufri, Tiranë, 2010, f. 98-99.

¹⁰ Lindita Tahiri, *Monologu personazhi dhe autori*, Kosova PEN Center, Prishtinë, 2006, f.25-26.

¹¹ Rexhep Qosja, *Letërsia shqipe dhe gjuha letrare*, në: "Letërsia shqipe dhe gjuha letrare", Prishtinë, 1998, f. 22.

¹² Lindita Tahiri, *Monologu personazhi dhe autori*, Kosova PEN Center, Prishtinë, 2006, f. 248.

KREU I: Leksiku i qytetit të Gjirokastrës

1.1 Shëmbyllyra e qytetit

Kadareja në romanin e tij *Kronikë në gur* para së gjithash ka dashur të na japë mishin e butë të jetës nën koracën e gurit. Për të qyteti s'është vetëm një koncept arkitektural dhe urbanistik. Një qytet ta banorë, në vetvete, s'ka kuptim. Në marrëdhëniet e figurës së goditur të "mishit të butë të jetës nën koracën e gurit" shkrimtari ka dashur të theksojë se edhe në kohëra të vështira të jetës simbolika e tij është e madhe.

Autori ka një vështrim dialektik mbi jetën dhe realitetin kohor që ai përshkruan. Ai na jep gjendjen ambivalente të qytetit dhe të banorëve të tij, kontraditat shoqërore në momentin e Luftës nacional-çlirimtare. Krahas materialit artistik autori ka futur në roman edhe mjaft materail dokumentar në formë fragmentesh. Kjo ka ndihmuar shumë jo vetëm nga ana kompozicionale, por edhe në pasurimin dhe konkretizimin e përmbajtjes, i jep kolorit romanit, sqaron më tepër situatat¹³.

Ky ishte një **qytet i çuditshëm**, që dukej sikur kishte dalë në luginë papritur një natë dimri si një qenje prehistorike dhe, duke u kacavjerur me mundime të mëdha, i ishte qepur faqes së malit¹⁴.

Kështu merrte fund jeta e lirë dhe gazmore e pikave të shiut. Atje, në strenën e errët e të shurdhër, ato do të kujtonin pastaj me pikëllim hapësirat qiellore, që nuk do t'i shihnin më kurrë **qytetet e habitshme** poshtë tyre dhe horizontet plot me vetëtima¹⁵.

Rrëfimi në vetën e parë, është thurur me disa fije njëherësh: për veten, vendlindjen dhe për luftën. Rrëfimtari-fëmijë, që është njëherësh edhe heroi, ndonëse mbart shumë të dhëna psiko-familjare të autorit, nuk është shëmbëlltyrë e tij, por një personazh i trilluar, prandaj, "*Kronikë në gur*" është krijim letrar i mirëfilltë dhe jo biografi për fëmijërinë e Ismail Kadaresë¹⁶.

Çdo udhëtari, që e shikonte për herë të parë, **qyteti i zgjonte dëshirën për të bërë një krahasim**, por menjëherë pasi udhëtari binte në grackë, **qyteti e flakte krahasimin**, sepse ky ishte një **qytet që nuk ngjante me asgjë**¹⁷.

Ishte me të vërtetë një **qytet shumë i çuditshëm**¹⁸.

¹³ Moikom Zeqo, *Shënime për romanin "Kronikë në gur"*, Zëri i rinisë, e shtunë, 8 janar, 1972, f. 5.

¹⁴ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, Onufri, Tiranë, 2005, f. 5.

¹⁵ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 16.

¹⁶ Bashkim Kuçuku, *Pas eklipsit letrar*, Botimet Toena, Tiranë, 2014, f. 212.

¹⁷ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 5.

¹⁸ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 6

Çdo dimër përpiqej **ta kafshonte qytetin** nga këmbët¹⁹.

Vështroja pamjen e ndryshuar brenda natës dhe mendoja se si lumi e urrente urën, udha automobilistike urrente me siguri lumin, përrenjtë surreni muret, era urrente malin që i priste furinë dhe të gjitha këto **bashkë urrenin qytetin**, i cili shtrihej i lagur, gri dhe mospërfillës, midis këtij pezmi shkatërrimtar. Unë e doja atë, sepse në këtë luftë ai ishte i vetëm²⁰.

Fëmijëria dhe vendlindja, të pandara në jetën dhe në psikologjinë njerëzore, te “Kronikë në gur” shpërfaqen magjishëm, me ngjyra poetizuese dhe dramatike, në sfodnin e Luftës së Dytë Botërore²¹.

Ja, unë drejtoj fytyrën nga lagjet e poshtme të **qytetit dhe sytë**, si dy pompa të fuqishme, fillonin të thithnin dritë dhe pamje të ndryshme²².

Qyteti shtrihej krejtësisht i pambrojtur nën qiellin vjeshtor, i cili u dukej të gjithëve më i hapur se zakonisht²³.

Mbi **qytet** mbeti bishti i përzishëm i tymit. Ndërsa njerëzit bërtisnin, ulërinin, shanin, era e lehtë e jugut e shtrajtoi tymin në dy-tri vende. Pastaj era e veriut më e egër se ajo e jugut, e preu keqas, gjersa më në fund e copëtoi. Mbeturinat e tij endën për **një kohë të gjatë mbi qytet**²⁴.

Një turmë u nis pothuaj me **vrap në veri të qytetit**, atje ku duhej të kishte rënë avioni. Ata që mbetën, dolën nëpër dritare, dhe po ndiqnin me sy ballin e turmës, që, pasi kapërceu rrugën e Varoshit, po nxinte tani në ashpërinën e Zallit²⁵.

Qyteti i lindjes në romamin *Kronikë në gur*-mbart karakteristika që e bëjnë atë një qytet atipik dhe duke u parë nga sytë e një fëmije plot përjetime të veçanta, është shënjeshti i vizionit të parë të botës, është përfytyrimi artistik i saj dhe i pamjeve të ndryshme ku ajo përthyeret: rrëmuja, çudia, mahnitja, drama²⁶.

Turma po largohej drejt qendrës. Dora e këputur e pilotit, **dora që goditi qytetin**, tundej e frikshme mbi gjithçka²⁷.

¹⁹ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 21.

²⁰ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 21.

²¹ Bashkim Kuçuku, *Pas eklipsit letrar*, Botimet Toena, Tiranë, 2014, f. 212.

²² Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 28-29.

²³ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 122.

²⁴ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 129.

²⁵ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 129.

²⁶ Viola Isufaj, *Qyteti dhe qytetërimi në vepra të Kadaresë*, në: “Letërsia dhe qyteti”, Tiranë, 2009, f. 179.

²⁷ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 131.

U rrëzua **avioni i parë mbi qytetin tonë**. U gjend krahu i pilotit. **Qyteti ynë nuk kishte parë kurrë një pamje të tillë apokaliptike**²⁸.

U rrëzua **avioni i parë mbi qytetin tonë**. U gjend krahu i pilotit. **Qyteti ynë nuk kishte parë kurrë një pamje të tillë apokaliptike**²⁹.

Qielli ishte mbushur plot me avionë. Ata vërtiteshin e vërtiteshin mbi **qytetet si lejlekët dhe pastaj, njëri pas tjetrit**, shkëputeshin e uleshin në fushën e re të aeroportit³⁰.

Qyteti pranoi i bindur errësimin³¹.

Qyteti ishte vërtet në ethe³².

Gjatë gjithë javës **qyteti u bombardua** çdo ditë³³.

Kishte ardhur një kohë e **vështirë për katin e tretë të qytetit**. Gjatë **ndërtimit të qytetit**, druri si më dinak ishte ngjitur në katin e tretë, duke i lenë gurit themelet, bodrumet dhe sterat³⁴.

Qyteti ynë nuk kishte parë kurrë një imazh të tillë apokaliptik³⁵.

Qielli ishte mbushur plot me avionë. Ata vërtiteshin e vërtiteshin **mbi qytet** si lejlekët dhe pastaj, njëri pas tjetrit shkëputeshin e uleshin në fushën e re të aeroportit³⁶.

Edhe ne kur shkonim në **arat jashtë qytetit vidhnim misra** dhe bënim shumë gjëra që s'do të guxonim t'i bënim **brenda në qytet**³⁷.

Qyteti i lodhur e i zymrtë, kishte kaluar disa herë rresht nga durat e italianëve në durat e grekëve dhe anasjelltas³⁸.

Qyteti mbeti pa pushtet³⁹.

²⁸ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 131.

²⁹ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 131.

³⁰ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 133.

³¹ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 71.

³² Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 77.

³³ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 84.

³⁴ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 87.

³⁵ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 102.

³⁶ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 103.

³⁷ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 108.

³⁸ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 113.

³⁹ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 116.

Të pretmen ata ishin në **qytet gjatë ditës dhe gjatë mbrëmjes**, por të shtunën në mëngjez **qyteti u gdhi krejtësisht i braktisur**⁴⁰.

I tërhequr për një farë kohe nga aventura, **qyteti pasi kishte njohur shijen e qiellit e të rreziqeve ndërkombëtare**, ishte i trullosur nga të gjitha këto dhe tani qe tërhequr pësëri në gurët e tij të lashtë⁴¹.

Në piedestalin e **monumentit të vetëm të qytetit**, ishin ngjitur njera mbi tjetrën afishet me urdhërat e komandantit italian dhe të **komandantit grek të qytetit**⁴².

Nisja e Kako Pinos për në dasmë donte të thoshte se **qyteti mund të jetonte edhe pa pushtet**. Megjithatë, koha ishte e pasigurtë si cdo kohë kalimtare⁴³.

Qyteti po merrej me ngjarje të vogla, të parëndësishme⁴⁴.

Aeroplanët e hutuar ishin bërë **kohët e fundit një gjë e zakonshme në qiellin e qytetit**⁴⁵.

Pas disfatës që pësoi një ditë më parë, **qyteti shtrihej si i trullosur me catitë dhe strehët e varura e të qullura**⁴⁶.

Një copë mëndafsh, që tundet nga era, **mund të dëshpërojë një qytet të tërë**. Ishte e cuditshme⁴⁷.

Një reshter grek qëllloi me armë, por nuk vrau njeri. Ai goditi në kofshë statujën e vetme të **qytetit**. Kjo ishte një statujë e madhe prej bronxi që ngrihej në sheshin e qendrës. Ajo ishte ngritur në kohën e mbretërisë. Përpara saj, **qyteti** nuk kishte pasur kurrë asnjë statujë⁴⁸.

Gjatë natës, mbi supet e njeriut prej bronxi dikush kishte hedhur një batanije. Qysh atëherë **qyteti u dashurua pas statujës së tij**⁴⁹.

Emri i gruas që kishte terrorizuar **njëzet e ca vjet më parë qytetin tonë**, kshihte qenë për mua si fjala “murtajë”, “flamë”, “gjëmë”, të cilat ishin të pranishme në shumicën e mallkimeve, që njerëzit i bënin njeri-tjetrit⁵⁰.

⁴⁰ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 116.

⁴¹ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 118.

⁴² Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 118.

⁴³ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 119.

⁴⁴ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 120.

⁴⁵ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 123.

⁴⁶ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 129.

⁴⁷ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 130.

⁴⁸ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 131.

⁴⁹ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 131.

Refugjatët po u ngjiteshin pa **pushim rrugëve të qytetit**. **Qyteti hijerëndë** vështronte të mundurit⁵¹.

Të nesërmen u mor vesh se në **të gjithë qytetin** ishin bërë arrestime. **Në sheshin e qytetit** u vendos një lajmërim i madh ku premtuhej një shumë prej 40.000 lekësh për atë që do të gjente zjarrvënësin⁵².

Qyteti me gjithë ketë dimër që shkoi, nuk kishte harruar djaln me flokë të çelët⁵³.

Dikush kishte sjellë në qytet lajmin e vdekjes së parë midis partizanëve⁵⁴.

Gruaja e Mane Vocos, pasi u shpëtoi atyre që e mbanin po vraponte tani si e **çmendur mes për mes qytetit**⁵⁵.

Askush nga rojet e sheshit nuk kishte dyshuar, kur aty nga mesnata, kishte ardhur në shesh karroca e komunales, e tërhequr nga kali plak Balashi, **që e njihte gjithë qyteti**⁵⁶.

Qyteti ishte përgjakur⁵⁷.

Qyteti ishte i shëmtuar vërtet⁵⁸.

Qyteti i ngjyer me llum, pas një nate të shqetësuar u gdhi edhe më i mvrejtur. Në mesnatë kishin hyrë, duke kënduar këngë të vjetra, bandat e Isa Toskës⁵⁹.

Qyteti ishte i madh dhe i egër⁶⁰.

Qyteti ngulçonte si në kllapi. Ai fliste përçart. Murmurima e tij ishte e zymtë: Thrriste vdekjen⁶¹.

Qyteti po zbrazej. Parandihej vetmia e madhe e gurit⁶².

Tani, gjysmë i braktisur, i ngjashëm **me një qytet prehistorik** ku jeta ka pushtuar prej kohësh, karrocë e gurtë, gjysmë bosh, ai priste gjermanët⁶³.

⁵⁰ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 133.

⁵¹ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 140.

⁵² Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 162.

⁵³ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 163.

⁵⁴ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 179.

⁵⁵ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 188.

⁵⁶ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 189.

⁵⁷ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 190.

⁵⁸ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 195.

⁵⁹ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 196.

⁶⁰ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 197.

⁶¹ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 198.

⁶² Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 205.

⁶³ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 219.

Qyteti, pasi bëri zakonin, priste me qetësi hakmarrjen⁶⁴.

1.2 Shëmbylltyra e Kronikës në gur

Autori e ka quajtur romanin e tij “Kronikë në gur” duke nënzivuar qysh në fillim se ngjarjet e kësaj kronike s’janë diçka që harrohet lehtë, por janë të qëndrueshme dhe të paharrueshme si gërmat e gdhendura të një lapidari. Gjirokastra është një lapidar i tillë i kohrave.

Një veçori tjetër e romanit është fakti se bota shpesh shikohet nga sytë e fëmijës, i cili është protagonist i kryesor i romanit, por pa e patur parasysh këtë veçori, shumë gjëra në roman nuk mund të kuptohen drejtë⁶⁵.

Gjithshka në këtë **qytet ishte e vjetër dhe e gurtë**, duke filluar nga **rrugët dhe çesmat** e gjer te **çatitë e shtëpive të tij të mëdha, shekullore**, që ishin të mbuluara me pllaka guri ngjyrë gri, të cilat u ngjanin luspave gjigande⁶⁶.

Ajo është e lidhur thellësisht me truallin e vet amtar shoqëror, psikologjik, emocional dhe letrar. Prandaj është fryti më i çmuar i qenies dhe i vetëdijes shqiptare, i kulturës shumëshekullore dhe i etnosit të lashtë shqiptar⁶⁷.

Tani ato vraponin tërë gaz e bujë nëpër **pllakat e gurta** dhe, vetëm unë me kryet nën velenxë ua qaja hallin⁶⁸.

Kështu merrte fund jeta e lirë dhe gazmore e pikave të shiut. Atje, në strenën e errët e të shurdhër, ato do të kujtonin pastaj me pikëllim hapësirat qiellore, që nuk do t’i shihnin më kurrë **qytetet e habitshme** poshtë tyre dhe horizontet plot me vetëtima⁶⁹.

Letërsia shqipe, për shkaqe historike dhe letrare, në afro pse shekuj me radhë, në pjesën më të madhe të herëve është zhvilluar në një rrugë të pangjashme me letërsinë evropiane, me shmangie prej kalendarëve të logjikshëm të përgatitjes së një dukurie a rrjedhe letrare prej asaj që ishte më parë⁷⁰, asimetrike në pikëpamjen e kronologjisë dhe të vijueshmërisë⁷¹.

⁶⁴ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 219.

⁶⁵ Moikom Zeqo, *Shënime për romanin “Kronikë në gur”*, në: “Zëri i rinisë”, e shtunë, 8 janar, 1972, f. 5.

⁶⁶ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 5.

⁶⁷ Bashkim Kuçuku, *Kadare në gjuhët e botës*, Onufri, Tiranë, 2000, f. 12.

⁶⁸ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 16.

⁶⁹ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 16.

⁷⁰ Shaban Sinani, *Historia e letërsisë shqipe-Çështje të hapura*, Naimi, Tiranë, 2015, f. 91-92.

⁷¹ Ali Xhiku, *Letërsia shqipe si polifoni*, Tiranë, 2004, f. 13.

Ky ishte një qytet i pjerrët, ndoshta më i pjerrëti në botë, që i kishte thyer të gjitha ligjet e arkitekturës dhe të urbanistikës⁷².

Kronikë në gur është një roman i ndërtuar në një formë pak të çuditëshme. Duket sikur arkitektura e ndërtimit të tij është asimetrike. Kadareja e respekton shumë fjalën dhe shtyfishon forcën e saj të cilën ai e ndjen vetë i pari gjatë procesit të shkruarit⁷³.

Por, ndërsa lumi fryhej e krekoj me mendjemadhësi **në këmbët e qytetit**, përrënjtë i hidheshin atij në shpinë pabesisht⁷⁴.

Ne ecnim drejt **qendrës së qytetit**. Rrugër ishin mbushur plot me tinguj të huaj. Ishtë ditë tregu. Nga të gjitha drejtimet fshatarët po dyndeshin drejt **sheshit të qendrës**⁷⁵.

Nga të dyja anët e rrugës, tritare e shtëpive të mëdha ishin të mbylluara fort. Prapa tyre, ulur nëpër shtrojat e buta, zonjat e mëdha ankoreshin tani me siguri për erën e fshatërve që vinte nga rruga, zinin hundët me dorë, zverdheshin, u vinte për të vjellë. Ato ishin të shëndosha, **me fytyra të bardha e të rrumbullakëta dhe dilnin shumë rrallë nëpër qytet**⁷⁶.

Porsa kalova Urën e Grindjes dhe dola te rruga e kështjellës, **qyteti u çlirua përnjëherësh nga pirgjet dhe kukuvajkat**. Pjesën e fundit të rrugës e bëra pothuaj me vrap⁷⁷.

Letërsia jeton në gjuhën me të cilën është shkruar, duke qarkulluar natyrshëm brenda kufijve të saj dhe, po ashtu, duke ndikuar në hapësirat e gjuhës së vet⁷⁸.

Ndërtimi i aeroportit ishte gjithashtu një bisedë e përditshme. Fjala “aeroport”, e shtypur pa mëshirë **nga dhëmbët dhe gjysmëdhëmbët e të gjitha plakave të qytetit**, dilte prej tyre aq e gjymtuar, saqë mezi njihej; e megjithatë, ato por edhe (kokrriza rëre të lagura me pështymë), të lidhura në mënyrat më qesharake me njëra-tjetrën, kishin një forcë tronditëse⁷⁹.

Një përvojë e fortë e së tashmes zgjon tek poeti kujtimin e një përvoje të mëparshme, (që përgjithësisht i përket fëmijërisë) nga ku lind tashmë një dëshirë që e gjen realizimin e saj në veprën

⁷² Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 5.

⁷³ Moikom Zeqo, *Shënime për romanin “Kronikë në gur”*, në: “Zëri i Rinisë”, e shtunë 8 janar, 1972, f. 6.

⁷⁴ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 21.

⁷⁵ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 32.

⁷⁶ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 33.

⁷⁷ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 73.

⁷⁸ Bashkim Kuçuku, *Kadare në gjuhët e botës*, vep. e cit., f. 9.

⁷⁹ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 93.

e krijuar. Si vepra krijuese, ashtu edhe ëndrrat me sy hapur janë një vazhdim dhe një zëvendësim i lojës së vjetër fëminore⁸⁰.

Dëgjova për një kohë të gjatë dhe përsëri nuk mora vesh asgjë. Ato flisnin për njëfarë shtëpie. Italianët kishin hapur një shtëpi. Kjo shtëpi kishte një emër të thjeshtë. Diçka që ngjante me **bibliotekën publike të qytetit**. E megjithatë ato tmerroheshin. Ato e mallkonin atë. Kisha dëgjuar për shtëpi prej sheqeri, të të cilat banojnë nuse të bukura. Kjo shtëpi duhej të ishte prej helmi, përderisa kishte fuqi të hidhëronte një qytet të tërë⁸¹.

Titulli është metonimi me disa shkallare, në të cilën guri nënkupton qytetin dhe qyteti banorët. E ashtuquajtura kronikë më tepër është për ta. Meqenëse ky qytet është ndërtuar krejtësisht prej guri, edhe historia ose kronika e tij përfytyrohet sikur është shkruar në gur dhe jo në letër, siç shkruhen zakonisht, duke nënkuptuar edhe një gdhendje arti të përjetshme⁸².

Do të vërë mend ky mitet, moj Selfixhe, apo jo, thirri Xhexhoja duke iu drejtuar gjyshes, sikur kjo të ishte përfaqësuese e qytetit⁸³.

Kati i tretë ishte i lehtë, gati i mosqenë. **Ai ishte ëndrra e qytetit**, trilli i tij, fluturimi i fantazisë së tij. E megjithatë, kjo fantazi ishte e kufizuar. Duke i dhënë liri katit të tretë, **qyteti dukej sikur** që penduar dhe kishte shpejtuar të ndreqte gabimi⁸⁴.

Ndërkaq qyteti bombardohej rregullisht. Aeroplanët vërtiteshin mbi të si në shtëpinë e tyre. Bateria kundërajrore, që e kishin nisur para një jave për **mbrojtjen e qytetit**, ende nuk kishte mbërritur. Pas bombardimit të parë të gjithë e kuptuan se një **qyteti parve rrugëve**, tymtarëve dhe kanaleve të ujërave të zeza, duhet të ketë edhe bateri kundërajrore⁸⁵.

Portretizimi, paraqitja e qytetit nga Ismail Kadareja nuk është i gjithi real dhe as i gjithi negativ. Ai, po ashtu, eksperimentoi një magjepsje nga jeta e qytetit-çka e peshon më shumë dhe e tejkalon neverinë⁸⁶.

Sa qejf,-tha ai,-**qyteti ynë u bë me aeroplanë**. Shumë qejf, - i thashë. Tani ne jemi të tmerrshëm. Tani do të bombardojmë edhe në **qytetet e tjera**, ashtu siç na bombardonin ata gjer tani⁸⁷.

⁸⁰ Sigmund Frojd, *Psikanaliza e artit dhe e letërsisë*, Dituria, Tiranë, 2000, f. 25.

⁸¹ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 89-90.

⁸² Bashkim Kuçuku, *Pas eklipsit letrar*, Botimet Toena, Tiranë, 2014, f. 212.

⁸³ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 99.

⁸⁴ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 114-115.

⁸⁵ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 122.

⁸⁶ Viola Isufaj, *Qyteti dhe qytetërimi në vepra të Kadaresë*, në: "Letërsia dhe qyteti", Tiranë, 2009, f. 183.

⁸⁷ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 136.

Ismail Kadreja nuk i tipizon personazhet me anë të gjuhës, ai nuk i vë vetes qëllim që të gjejë profesionalizma, dialektizma, arkaizma apo ndonjë shprehje “të preferuar”. Kjo do të ishte gjëja më e lehtë dhe jo thelnësore. Ajo më e rëndësishmja qëndron në faktin se gjuha shpreh mendimin, botëkuptimin e karakterit, idealin që e shtyn të bëjë këtë apo atë veprim. Të tipizuarit e personazhit me anë të gjuhës për nga masa, shkalla e kulturës, profesioni etj., nuk do të vlente shumë në qoftë se fjala nuk të shpie në kushtet ku ëhstë formuar. Edhe në ato pak shkrime që kmei për gjuhën e veprave letrare, vemë re se artikujshkruesit janë marrë me drejtshkrimin, leksikun, morfologjinë apo sintaksën, duke i parë këto të shkëputura nga njëra tjetra dhe jo në funksion të zbulimit të karakterit⁸⁸.

Netët ishin të errëta. Pasdarke ne të gjithë rrinim në dhomën e madhe, pranë dritareve, me sytë ngulur në errësi. Qëllonte që nga bregu i Zallit, drita e projektorit zgjatej si një kërmill, duke **kërkuar në errësi qytetin**⁸⁹.

Duke ruajtur me vështirësi jetën njerëzore në gjymtyrët dhe nën lëvozhgën e tij të gurtë, **qyteti i shkaktonte asaj pa dashur shumë dhembje**, gërvishje dhe plagë, dhe kjo ishte një gjë e natyrshme, përderisa ky ishte një **qytet prej guri**, dhe çdo prekje e tij ishte e ashpër dhe e ftohtë⁹⁰.

Ishte e vështirë të ishte **fëmijë në këtë qytet**⁹¹.

Atje, në sterën e errët e të shurdhër, ato do të kujtonin pastaj me pikëllim hapësirat qiellore që nuk do t’i shihnin më kurrë, **qytetet e çuditshme poshtë tyre dhe horizontet plot me vetëtimë**⁹².

...sepse qyteti ynë ishte i pjerrët, dhe në këtë **qytet mund të ndodhte çdo gjë**⁹³.

Metonimia e simbolizuar përfshin edhe mënyrën e jetesës, normat morale, zakonet dhe traditat e vjetra, të paluajtshme, të pandryshueshme, ngjashëm me gurët e kalasë, të rrugëve, shtëpive⁹⁴.

Edhe ata si lumi mundoheshin të **kafshonin qytetin**. Por ndërsa lumi fryhej e kapardisej me mendjemadhësi në **këmbët e qytetit**.....⁹⁵.

⁸⁸ Xhafer Martini, *Jeta në gjerësi dhe thellësi*, revista: “Nëntori”, 18 korrik, 1971, f. 8.

⁸⁹ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 136.

⁹⁰ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 6.

⁹¹ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 6.

⁹² Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 7.

⁹³ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 8.

⁹⁴ Bashkim Kuçuku, *Pas eklipsit letrar*, Botimet Toena, Tiranë, 2014, f. 212.

⁹⁵ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 12.

...era urrente malin që i priste furinë, dhe të gjitha këto bashkë **urrenin qytetin**, i cili shtrihej i lagur, gri dhe mospërfillës, midis kësaj urrejtjeje shkatrimtare. Unë e doja atë, sepse në këtë luftë ai ishte i vetëm⁹⁶.

Tani gjithshka ishte e qartë; **në qytet kishin shpërthyer magjitë**⁹⁷.

Qyteti, i madh dhe i vrenjtur, pasi kish përbuzur shira, breshëra, bubullima, e ylbere, hante tani vetëveten⁹⁸.

Në atë lëmsh të mbështjellë me lecka të neveritshme, na dukej sikur mbanin **ankthin e qytetit**⁹⁹.

⁹⁶ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 12-13.

⁹⁷ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 30.

⁹⁸ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 36.

⁹⁹ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 38.

KREU II: Leksiku i emrave të personazheve dhe gjuha e qytetit në romanin *Kronikë në gur*

2.1 Leksiku i përdorimit të emrave të personazhave në roman

Në këtë roman, më mirë se në çdo vepër tjetër të autorit, sipas mendimit tim, gërshetohet e vërteta jetësore me të vërtetat artistike, duke krijuar një unitet ideo-artistik. Qyteti ka marrë një vlerë përgjithësuese, por edhe fytyrën e tij të veçantë. E veçantë në këtë qytet është pozicioni, arkitektura, mënyra e jetesës, kurse e përgjithshme është se ai i ka të gjitha shqetësimet, që kanë qytetet e tjerë, të cilët vuajnë nën zgjedhën e rëndë të pushtetit. Duke krijuar një galeri të tërë personazhesh, autori nuk merret me skalitjen e tyre, nuk tregon historinë e formimit të tyre, por duke i vënë ata në situata dhe rrethana të caktuara, shpreh idealin e tij pozitiv. *Kronikë në gur* është një roman situatash, ambinetesh, tabllosh, rrethanash ku bëhet lëvizja e personazheve¹⁰⁰.

Gjuha shqipe gjendet sot pikërisht në etapën e modernizimit. Rrafshi gjuhësor që u përgjigjet më drejtpërdrejt kërkesave të modernizimit është leksiku. Për gjuhën shqipe, ku norma drejtshkrimore e gramatikore ka arritur tashmë një shkallë të lartë qëndrueshmërie, modernizimin do të thotë, në radhë të parë, pasurimin sistemor i leksikut, në mënyrë që ai t'u përgjigjet me emërtime të sakta nocioneve, veprimeve, objekteve të një shoqërie moderne¹⁰¹.

Në një vështrim të përgjithshëm mund të themi se për personalitetin shkrimtarit tonë Ismail Kadare, leksiku në romanin *Kronikë në gur*, në lidhje me qytetin dhe përfytyrimin e tij, është një pasuri e vlerës gjuhësore.

Te porta u dëgjua zhurmë dhe hynë njëri pas tjetrit, të lagur qull: ***Xhexhoja, Mane Vocoja dhe Nazoja*** bashkë me nusen e djalit¹⁰².

Kontraditat në këtë roman kanë si arenë shtresën e trashë të ambientit mikroborgjez. E rëndësishme është të vihet në dukje se mikroborgjezia është parë në shumë aspekte, por gjithnjë në formën konçize e poetike, që karakterizon stilin e autorit. Forcat që i kundërvihen kësaj mikroborgjezie qytetare, sidomos në fillim, janë të dobëta. Ato nuk ndeshen drejtpërdrejt me të, por nga përmbajtja ndjehet se ato kanë energji të thejnë këtë shtresë të fortë të këtij ambienti. Këta forca janë jo vetëm fëmijët, Isai e Javeri apo disa ilegalë, por edhe tërë zhvillimi i ngjarjeve që e bën të domosdoshëm

¹⁰⁰ Xhafer Martini, *Jeta në gjerësi dhe thellësi, mbi romanin Kronikë në gur*, në revista: "Nëntori", 18 korrik 1971, f.7.

¹⁰¹ Idriz Ajeti & Emil Lafe, *Njëzet e pesë vjet nga kongresi i Drejtshkrimit*, në: "Studime filologjike", nr. 12, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 1998, f. 5-6.

¹⁰² Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 18.

transformimin e këtij qyteti, e bën atë të jetë në ethe, të gulçojë dhe heroit të vogël t'i duket se ai po bën një lëvizje të mundimshme për t'u transformuar¹⁰³.

Porta kërciti prapë dhe hyri me vrap **Javeri**, bashkë me **Maksutin, djalin e Nazos**, me nga një enë të madhe në duart¹⁰⁴. Rrija te shkalla dhe po vështroja njerëzit që vërtiteshin gjithë zhurmë: **Mane Vocon**, të gjatë e të hollë me leshrat e thinjura, djalin dhe nusen e bukur të **Nazos**, me sy të përgjumur, **Xhexhon**, që mezi merrte frymë. **Mane Vocoja, Xhexhoja dhe Nazoja** nxirrnin vedrat njëra pas tjetrës, ndërsa im atë dhe të tjerët, i zbraznin te dera e oborrit¹⁰⁵.

Botëkuptimi naiv apo idealist i mikroborgjezisë nuk e lejon atë të shpejtojë drejt ngjarjet shoqërore; prandaj ajo tmerrohet nga çdo fenomen i ri, alarmohet nga çdo gjë që dëgjon. Më bukur se çdo mjet këtë në roman e ndeshim në dialogjet alarmantë dhe në fundin etyre, në leitmotivin e vazhdueshëm të Xhexhos: "Kiameti". Vetë mjetet fantastike, herë herë groteskte apo disi psikopatike që ndeshim në roman, janë paraqitje, përmes një refleksi fëminor, të psikologjisë mikroborgjeze, që i zmadhon faktet e ngjarjet, i paraqet në forma të pakuptueshme, të çuditshme¹⁰⁶.

Jashtë shiu vazhdonte të binte me shtamba dhe herë pas here **Xhexhoja** thoshte me zërin e saj me hunbë: Pupu, ç'kiamet¹⁰⁷.

Xhexhoja u hoq mënjanë që të çlodhej dhe ndezi një cigare¹⁰⁸.

E dëgjove?-tha duke iu afruar gjyshes. –**Vajzës së Çeço Kailit** i ka dalë mjekër¹⁰⁹.

Personazhet e plakave kanë një rol kryesor. Ato shquhen për karakterizim gjuhësor të theksuar, të thukët e mjeshtëror. Gjyshja Selfixhe, hallë Xhemoja, Kako Pinua, Xhexhoja, Nënëmadhja, Plakat e jetës, Plakat Katënxhika, formojnë një kor të lashtë e të përjetshëm, me disa zëra të dallueshëm qartë¹¹⁰.

Për këta sy, -tha **Xhexhoja**.-Mjekër e zeze na, si e burrave. Ndaj s'e lë i ati të dalë udhëve¹¹¹.

Uh, moj Selfixhe, -rënkoi **Xhexhoja**, -të zehtë ne, të zehtë! Ç'shenja të këqija që na dërgon Zoti! Ja, ky kiamet i zi sonte¹¹².

¹⁰³ Jakup Mato, *Kronikë në gur dhe disa tendenca të romanit tonë*, revista: "Nëntori", nr. 7, korrik, 1972, f. 29.

¹⁰⁴ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 18.

¹⁰⁵ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 18-19.

¹⁰⁶ Jakup Mato, *Kronikë në gur dhe disa tendenca të romanit tonë*, revista: "Nëntori", nr. 7, korrik, 1972, f. 30.

¹⁰⁷ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 19.

¹⁰⁸ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 19.

¹⁰⁹ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 19.

¹¹⁰ Bashkim Kuçuku, *Pas eklipsit letrar*, Botimet Toena, Tiranë, 2014, f. 213.

¹¹¹ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 19.

Duke ndjekur me sy nusen e bukur të **Nazos** që ishte martuar para tri javësh, **Xhexhoja** i tha diçka me zë të ulët gjyshes. Gjyshja kafshoi buzën. Unë u afrova të dëgjoja, por **Xhexhoja** hodhi cigaren dhe shkoi te gryka e pusit¹¹³.

Ç'kohë është vallë?-pyeti **Mane Vocoja**¹¹⁴.

Mesorja ishte gjysmë e errët dhe nëpër mure lëviznin hije të frikshme me trajta të paqendrueshme, sin ë kllapi¹¹⁵.

Kohë të këqija, kohë të turbullta, ah, moj **Xhiko**, është kohë e pabesë kjo¹¹⁶.

Këta përrenj ishin zakonisht pa ujë. Mbi faqen e malit ata ngjanin si gjarpërinj të ngrodhur, të tharë. Mirëpo, befas, në një natë furtune, ata ngjallehin, fryheshin, vërsellenin, cijasnin, ulërinin. Ja, tani vraponin tatëpjetë, të zbehtë nga zemërimi me ato emra të shkurtër si emra qensh (Përroi i Cullos, i Ficos, i Cfaqës), duke rrokullisur copëra ledhesh e gurësh, të rrëmbyera në vrap e sipër nga lagjet e sipërme¹¹⁷.

Autori tregon se ky ambient mikroborgjez, normat frenuese të rënda kanë çuar deri atje sa të perçundnohet natyra njerëzore, dhe të krijohen tipa të tillë si Argjir Argjiri, vajza e Çeço Kailit e të tjera që janë pjellë të këtij ambjenti¹¹⁸.

Duke mos hequr sytë andej po përpiqesha të kuptoja se ç'lidhje mund të kishte midis furtunës së mbrëmshme dhe vajzës së Çeço Kailit, mjekra ogurzezë e së cilës m'u kujtua papritur¹¹⁹.

Përmes detajeve zbërthet shkallë-shkallë varfëria shpirtërore intelektuale e kësaj shtrese mirkoborgjeze, si një nga tiparet kryesore të saj: gra e plaka që rrufisin kafënë e merren me vogëlsira, burra me borsalina që me seriozitet kalojnë kohën duke shikuar si theren bagëtia, dhe e quajnë gjë jo serioze të venë në kinema, pleq që çfletojnë mbi shezlong qitape të vjetra të pluhurosura, përpjekje qesharake për zbulime teknike etj¹²⁰.

¹¹² Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 19.

¹¹³ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 19.

¹¹⁴ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 20.

¹¹⁵ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 20.

¹¹⁶ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 20.

¹¹⁷ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 21.

¹¹⁸ Jakup Mato, *Kronikë në gur dhe disa tendenca të romanit tonë*, revista: "Nëntori", nr. 7, korrik, 1972, f. 30.

¹¹⁹ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 22.

¹²⁰ Jakup Mato, *Kronikë në gur dhe disa tendenca të romanit tonë*, revista: "Nëntori", nr. 7, korrik, 1972, f. 29.

Kishin ardhur për vizitë *Xhexhoja me Kako Pinon*. Rrinin mbi nim të dhomës së madhe, gjerbnin kafen dhe bisedonin me gjyshen. *Xhexhoja*, ishte e shqetësuar. *Xhexhoja*, ishte e shqetësuar¹²¹.

Kako Pinua, e imët, veshur krejt në të zeza, tundte vazhdimisht kokën thatime dhe, pas çdo fjale të *Xhexhos*, përsëriste si e nemitur: “kiameti”¹²².

Flisnin për Isanë, djalin e madh të *Mane Vocos*, i cili javën që shkoi kishte bërë një gjë të padëgjuar: kishte vënë size. Kur ma thanë, nuk e besova,-thoshte *Xhexhoja*,-u ngrita, hodha rizën në kokë e me vrap te *Mane Vocoja*. I ziu *Mane* e mbante veten, po gratë ishin prishur në fytyrë¹²³.

Xhexhoja mori frymë thellë. Gjyshja përmbysi filxhanin. Pse ta bënte këtë gjë Isai,-tha gjyshja me hidhërim. Gjithë ai djalë, i urtë, i menu. Ta bënte në birbo si ai *Lame Kareco Spiri*, hajde de, po Isai¹²⁴.

Në ato plaka kishte me të vërtetë diçka memoriale. Ato fjalë të pakta, ku nuk mund të gjeje kurrë asnjë gjurmë gabimi sintakse, raporti midis reales dhe ireales, bisedat, ajo mbishtresë legjende mbi faktet si suveniritet në të gjykuarit e botës¹²⁵.

Kështu, *moj Selfixhe*,-vazhdoi *Xhexhoja*,-pastaj ankohemi pse na vijnë gjithë këto të këqija. Vetë i kemi fajet, vetë. Dje ndërtuan shtëpi me letër, sot venë syze djemtë e rinj, nesër kushedi ç’do të ndodhë. Po ai që është atje lart,- *Xhexhoja* ngriti gishtin drejt qiellit, dhe zëri i saj u bë kërcënues,-ai të gjitha i shikon, të gjitha i numero. Nga hundët do ta na e nxjerrë. Kiameti,-tha *Kako Pinua*¹²⁶.

Kur *Xhexhoja* përmendi shtëpinë me letër, unë ktheva kokën e padashur nga lagjia “Gjobek”, atje ku ajo shtëpi e jashtëzakonshme prej fibre, e ngritur disa javë më parë nga italianët për murgeshat e tyre, rrinte tani midis shtëpive hijerënda prej guri, e huaj dhe e papajtueshme me to¹²⁷.

Tani ato gjykonin djalin e *Mane Vocos* me po ato fraza të frikshme, siç kishin gjykuar atëherë shtëpinë prej fibre¹²⁸.

Ato folën gjatë për këtë punë, dhe unë i dëgjova të gjitha me vëmendje, sepse ajo që kishte bërë djali i *Mane Vocos* kishte lidhje me një të fshehtën time¹²⁹.

¹²¹ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 25.

¹²² Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 25.

¹²³ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 25.

¹²⁴ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 26.

¹²⁵ Besnik Anxhaku, *Ismail Kadare në qytetin e gurtë*, Pakti midis shkrimtarit dhe vendlindjes, në gazetën “Albania”, e martë, 8 maj, 2001, faqe 10.

¹²⁶ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 26.

¹²⁷ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 26.

¹²⁸ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 27.

¹²⁹ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 27.

Kiameti, -ia bëri *Kako Pinua*, por tani ato kishin filluar biseda të zakonshme dhe të mërzitshme për shtrëngesën ekonomike, të cilat unë s'kisha dëshirë asnjëherë t'i dëgjoja¹³⁰.

Rruga e Varoshit ngjitej përpjetë me mundim, kurse nga e djathta e saj zbriste furishëm rruga e Gjobekut, e cila, pasi i larghe shtëpisë me fibër të murgesve italiane, sikur kjo të kishte murtajën, vinte e përplasej me rrugën e Varoshit dhe nga përplasja të dyja ishin shtrembëruar. Me tutje, Sokaku i të Marrëve, i verbër e kryenec, i sulej rrugës nazike të gjimnazit, por kjo në castin e fundit i bënte bisht goditjes dinakërisht duke u mënjanuar pak¹³¹.

Atëherë *Sakaku i të Marrëve* lëshohej tatëpjetë, mes për mes lagjes, sikur kërkonte grindje dhe, gjatë këtij vrapi bënte ca dredha nga më të papriturat e më të habitshmet¹³².

Nëpër këto dredha unë prisja tani që të shfaqej *Iliri*, djali tjetër i *Mane Vocos*, shoku im më i ngushtë. Kur e pashë që po vinte, zbrita shkallët me vrap dhe dola në rrugë¹³³.

Duke u ngjitur nëpër fortashtrojën e rrugës, pamë *Javerin dhe Maksutin*, *djalin e Nazos*, që po zbrisnin. Nuk flisnin fare dhe dukeshin të zemëruar¹³⁴.

Djali i Nazos i kishte sytë pak të dalë dhe unë vuaja shumë kur e shikoja. Një ditë, duke dëgjuar se si një grua i tha dy herë rresht fqinjës: "Të dalshin sytë", mua m'u kujtuan menjëherë sytë e tij. Tani, sa herë që e takoja në rrugë, më dukej se mund t'i dilnin sytë dhe mund t'i binin përdhë dhe pastaj, ndërsa ata do të rrokulliseshin nëpër pllaka, unë do t'ia shkelja padashur dhe sytë do të pëlcisnin¹³⁵.

Drejt nesh, me një velenxë hedhur krahëve dhe me rizën e bukës, që e mbante në dorë, po vinte *Llukan Burgamadhi*¹³⁶.

Para fshatërve, të cilët ato i thërrisnin të gjithë me emrin *Kiço*, dukemos harruar kurrë të vinin përpara emrit *Kiço* fjalën "me nder", ashtu sic bënin kur përmendnin nevojtoresh, thoshin se ato i mërziste shumë kjo kohë që po jetonin, dhe, ulur rradhë-rradhë mbi nim, duke gjerbur kupa të pafundme kafesh, ato prisnin kthimin e kohës së mbretërisë¹³⁷.

¹³⁰ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 28.

¹³¹ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 29.

¹³² Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 29.

¹³³ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 29.

¹³⁴ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 30.

¹³⁵ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 31.

¹³⁶ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 31.

¹³⁷ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 32.

Përpara nesh kishte ndaluar *Mane Vocoja, babai i Ilirit*. Mbante në dorë një bukë misri dhe një tufë qepësh të njoma¹³⁸.

Kurrë të mos shkoni më atje,-tha *Mane Vocoja* me zë të zbutur¹³⁹.

Mane Vocoja u largua. Dalëngadalë po na ikte hutimi. Pamja e tregut, përmes të cilit tani ecnin, po na qetësonte¹⁴⁰.

Xhexhoja dy-tri herë i hodhi sytë nga gjyshja, që nuk bëri gjë tjetër, veçse mblodhi pak buzët, sikur të thoshte: “Ç’të bësh, *moj Xhexho, vajzat e sotme kështu e kanë*”¹⁴¹.

2.2 Leksiku dhe gjuha qytetit në romanin “Kronikë në gur”

Në romanin *Kronikë në gur* hasim së fëmija si personazh kryesor, por edhe udhërrëfyes na jep detajet e këtij qyteti, jetën e përditshme, por dihet se ajo çka është më e dashur për një fëmijë është loja. Loja është puna më e shpeshtë dhe më e dashur për fëmijën, a nuk mund të themi që çdo fëmijë, duke luajtur, sillet si një poet, në momentin në të cilin krijon një botë të vetën ose më mirë, ndërsa rregullon në mënyrë të re sipas shijes së vet gjërat e botës së tij? Atij i pëlqen të lidhë objektet dhe situatat e imagjinuara me gjërat e prekshme e të dukshme e të botës reale. Poeti sillet si fëmija që luan. Ai krijon një botë fantazie të cilën e merr shumë seriozisht, - në të cilën pra investon një ngarkesë të madhe emotive - dhe e ndan qartësisht nga realiteti. Gjuha ka ruajtur këtë raport midis lojës së fëmijës dhe krijimit poetik duke përcaktuar me termin “spiel” (lojë), ato forma të veprës poetike që duhet të jenë të lidhura me objektet e prekshme e që janë të destinuara për përfytyrim¹⁴².

Tek Kadareja fjala shqipe gjeti një mjeshtër të madh ajo një “magjistër virtuoz” të përpunimit të saj artistik, siç është shprehur një kritik anglez për të. Edhe më gjerë akoma, mbarë kultura dhe mendimi intelektual shqiptar përmbledhi tek ai përmasat e një fenomeni të atillë, që vijnë vërtet aq rrallë, por që ndikojnë e kujtohen gjatë.

Misionet e mëdha nuk lypen e as nuk dekretohen, ato ngarkohen përmes talentit të njëmendët e një morie rrethanash të tjera letrare e jashtëletrare. Në këtë kuptim, nuk është i rastësishëm afirmimi i beftë i Kadaresë në fillim të viteve ’60, pikërisht mu në zgrip të atij golli që ishte krijuar nga

¹³⁸ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 33.

¹³⁹ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 35.

¹⁴⁰ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 35.

¹⁴¹ Ismail Kadare, *Kronikë në gur*, f. 35-36.

¹⁴² Sigmund Frojd, *Psikanaliza e artit dhe e letërsisë*, Dituria, Tiranë, 2000, f. 19.-20.

ndërprerja apo ryptyra në planin artistik e letërsisë së pasluftës së Dytë Botërore, e cila pothuaj i pati injoruar e atrofizuar lidhjet me traditat e mëdha të letërsisë shqipe pararendëse, me letërsinë botërore e pse jo edhe me folklorin, me të cilin spekulohet duke marrë disa klishe e motive të gatshme. Kadareja zuri vend në pararojën e atyre krijuesve që i riaktivizuan e ridimensionuan lidhjet me këto tri vatra të mëdha, duke asimiluar prej tyre mesazhe universale dhe një varg mekanizmesh e teknikash të ligjërimit artistik¹⁴³.

1. Qytete të habitshme,
2. Në këtë qytet mund të ndodhë çdo gjë,
3. Cdo dimër përpiqej ta kafshonte qytetin nga këmbët,
4. Lumi fryhej e krekosej me mendjemadhësi në këmbët e qytetit,
5. Era urrente malin që i priste furinë dhe të gjitha këto bashkë urrenin qytetin,
6. Si një pakt paqeje mes erës dhe qytetit,
7. Bejtexhiu i qytetit,
8. Ne ecnim drejt qendrës së qytetit,
9. Qyteti do ta përtypte në mbrëmje si një kalë i lidhur,
10. Ata nuk kthenin as kryet për të parë qytetin,
11. Rreth e rrotull qytetit,
12. Qyteti ynë ishte i pushtuar,
13. Qyteti kishte ushtarë të huaj,
14. Si mund të jetë një qytet i papushtuar,
15. Ju nuk mund ta kuptoni dot se ç'do të thotë qytet i lirë,
16. Ajo kishte stolisur të gjitha nuset e qytetit,
17. Edhe qyteti ynë po përgatitet ta presë sic duhet zotni Mutin,
18. Gjqyqi i vjetër po i shkakton shumë fatkeqësi qytetit tonë,
19. Aktualisht njeriu më rëndë i qytetit është Aqif Kashahu,
20. Komandanti i qytetit Bruno Arxhivokale,
21. Në qytet kishin shpërhtyer magjitë,
22. Në varrezat e qytetit bashkia caktoi një roje tjetër,
23. Qyteti, i madh dhe i vrejtur,
24. Qyteti është në ethe,
25. Na duhej sikur mbanim ankthin e qytetit,
26. Kjo lagje ishte një nga ato pjesë të qytetit,

¹⁴³ Ymer Çiraku, *Në zbërthim të kodeve letrare*, Toena, Tiranë, 1998, f. 24.

27. Aty ku kalonte kufiri i malit dhe i qytetit,
28. Rruga e kështjellës, që lidhte lagjet e sipërme të qytetit me qendrën,
29. Në kafënë, në qendër të qytetit,
30. Në këmbët e qytetit po ngrihej një aeroport,
31. Mund të jetë edhe për mbrojtjen e qytetit,
32. Dukej sikur qyteti kruhej ngadalë,
33. Në mëngjes qyteti dukej si i lodhur nga mundimi,
34. Qyteti, i mbushur papritur me pirgje, nxinte,
35. Qyteti u clirua përnjëherësh nga pirgjet dhe kukuvajkat,
36. Therja e shpendëve në qytet ishte një gjë tepër e rrallë,
37. Shpikësi i qytetit tonë Dino Çiço,
38. Urdhëroj errësim të detyruar në qytet,
39. Llamba me vajguri e të cilit shuhej e fundit në qytet,
40. Qyteti pranoi i bindur errësimin,
41. Gjysmëdhëmbët e të gjitha plakave të qytetit,
42. Në këtë qytet pjesa më e madhe e vjedhjeve bëhej gjithmonë nga lart,
43. Sikur donin të tregonin se nuk kishin asnjë punë me qytetin tonë,
44. Ai i ishte afruar qytetit në heshtje të plotë,
45. Cdo natë drita e projektorit kërkonte qytetin,
46. Kishte fuqi të hidhëronte një qytet të tërë,
47. Sikur kjo të ishte përfaqësuese e qytetit,
48. Qyteti ishte vërtet në ethe,
49. Kishte qytete të tjera plot me shtëpi dhe njerëz,
50. Mbi qytetet dhe shtetet,
51. Kështu qyteti u bë me sirenë alarmi,
52. Qyteti u nxi,
53. Sikur lajmëronte mbarimin e nderit të këtij qyteti,
54. Ky qytet u bë si Sodoma dhe Gomora,
55. Qyteti u drodh si epileptik, u anua, desh ra,
56. Për herë të parë në jetën e tij qyteti i stërlashtë,
57. Qyteti i trullësuar vështronte qiellin e hapur,
58. Bashkia e qytetit,
59. Qyteti nuk e fali sfiduesin e tij,
60. Qyteti u bombardua cdo ditë,

61. Qyteti i priste këto ditë,
62. Ai ishte ëndërra e qytetit,
63. Qyteti dukej sikur qe penduar dhe kishte shpejtuar të ndreqte gabimin,
64. Tani kudo nëpër qytet po ngjiteshin dërrasa si e jona,
65. Në vend që t'i hedhë bombat mbi kazermat e italianëve ose mbi aeroport, i vërtit mbi qytet,
66. Kur në këmbët e qytetit filloi ndërtimi i aeroportit,
67. Por edhe do ta nderonte emrin e qytetit,
68. Ndërkaq mbi qytet fluturonin vazhdimisht aeroplanë të ndryshëm,
69. Bateria kundërajrore, që kishin nisur para një jave për mbrojtjen e qytetit,
70. Ai i kishte sjellë pa pushim mbi qytet,
71. Disa thoshin se bateria ishte vendosur jashtë qytetit,
72. Kundërajrori i vjetër, që ishte vendosur mu në mes të qytetit,
73. Qyteti i beson mbrojtjen e vet,
74. Mbi qytet mbeti bishti i përzishëm i tymit,
75. Mbeturinat e tij u endën për një kokë të gjatë mbi qytet,
76. Një turmë u nis pothuaj me vrap në veri të qytetit,
77. U rrëzua avioni i parë mbi qytetin tonë,
78. Ata vërtiteshin e vërtiteshin mbi qytetet si lejlekët,
79. Qyteti ynë u bë me aeroplanë,
80. Tani do të bombardojmë edhe ne qytetet e tjera,
81. Duke kërkuar në errësirë qytetin,
82. Si janë qytetet e tjera?
83. Që s'do të guxonim kurrë t'i bënim brenda në qytet,
84. Qyteti i lodhur dhe i zymtë,
85. Qyteti mbeti pa pushtet,
86. Në qytet hynë përsëri italianët,
87. Të premtën ata ishin në qytet,
88. Qyteti u gdhi krejtësisht i braktisur,
89. Pati njerëz që shkuan gjer në qendrën e qytetit,
90. Në sheshin e qytetit era përplaste andej-këndeje copa të grisura gazetash,
91. Qyteti kishte mbetur pa zot,
92. Qyteti pasi kishte njohur shijen e qiellit e të rreziqeve ndërkombëtare ishte i trullosur,
93. Turpi po i kalonte kështu dalëngadalë qytetit,
94. Orëndreqësit më të dëgjuar të qytetit,

95. Kur të ripushtonin qytetin,
96. Lëshoi papritur e pakujtuar një bombë në qytet,
97. Aeroplani po fluturonte ngadalë mbi qytet,
98. Fluturonte ngadalë mbi qytet dhe dukej sikur pilotin e kishte zënë gjumi,
99. Në mëngjesin tjetër qyteti u gdhi përsëri i pushtuar,
100. Një copë mëndafsh, që tundet nga era, mund të dëshpëronte një qytet të tërë,
101. Qyteti kishte disa javë i pushtuar nga grekët,
102. Në mëngjes kryqi ishte përsëri aty, mby qytet,
103. Zorra e llastiktë do të hidhej mbi qytet,
104. Vec i hapi një vrimë në kofshë shtatores së vetme të qytetit,
105. Përpara saj qyteti nuk kishte pasur kurrë asnjë shtatore,
106. Në gazetën e qytetit u bë një ndeshje e ashpër,
107. Qysh atëherë qyteti u dashurua pas shtatores së tij,
108. Emri i gruas që kishte lemeritur njëzet e ca vjet më parë qytetin tonë,
109. Qyteti u gdhi me Vasiliqinë,
110. Në qytet hynë përsëri italianët,
111. Të shpërngulurit po u ngjiteshin pa pushim rrugëve të qytetit,
112. Qyteti hijerëndë vështronte të mundurit,
113. Nga e Şara e murit dukej një pjesë e qytetit,
114. Qyteti ishte poshtë, shumë poshtë,
115. Qyteti i tërë ishte mbedhur e po gdhihej nën një pullaz,
116. Ajo kishte pjellë qytetin,
117. Poshtë grehinës dukej qyteti,
118. Në këtë qytet dashuria ndalohet,
119. Pingul mbi qytetin,
120. Ç'mund t'i ndodhë një qyteti gjatë dimrit,
121. Ky ylber ra brenda në qytet,
122. Në të gjithë qytetin ishin bërë arrestime,
123. Në sheshin e qytetit u vendos një lajmërim,
124. Qyteti me gjithë fatkeqësitë e mëdha që i kishin rënë mbi krye,
125. Në qytetin tonë vepron një grup terroristësh,
126. Puset e qyteteve,
127. Në qytet vazhdonte të flitej,
128. Largojeni vëllavrasjen nga qyteti ynë,

129. Sepse ka dalë nga qyteti,
130. E priste qytetin më dysh,
131. Qyteti po egërsohej vërtet,
132. Qyteti u ngrys pa ata që kishin folur kundra,
133. Dikush kishte sjellë në qytet lajmin e vdekjes së parë midis partizanëve,
134. Kishin vrarë komandantin e qytetit,
135. Mes për mes qytetit,
136. Duke fluturuar mbi qytet,
137. Qyteti ishte përgjakur,
138. Këta janë nga qyteti ynë,
139. Urdhëroj regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë së qytetit,
140. Kryq e tërthor qytetin,
141. Një pjesë iknin përsëri nga qyteti,
142. Qyteti i zyrtë dimëror vështronte me mospërfillje të mundurit,
143. Atëherë ishte kthyer në qendër të qytetit me pamje të mjerë,
144. Qyteti ishte përbaltur si kurrë ndonjëherë në jetën e vet,
145. Qyteti ishte shëntuar vërtet,
146. Qyteti i ngjyer me llum, pas një nate të shqetësuar, u gdhi edhe më i vrejtur,
147. Qyteti ishte i madh dhe i egër,
148. Qyteti kishte nisur të kishte frikë nga sytë tanë,
149. Nata e gjeti qytetin të mbushur plot me ballistë,
150. Qyteti gulconte si në kllapi,
151. Qyteti po zbrazej,
152. Nuset e qytetit,
153. Në të dalë të qytetit mbetëm vetëm,
154. Qyteti kishte humbur vërtet,
155. Qyteti ishte atje, krejt i vetmuar midis nofullave të mjegullave që hapeshin
ngathtësisht nga të gjitha anët,
156. Malli për shtëpinë e qytetit më ra si bubullimë në kokë,
157. Atje në qytet kishin ujin e sternës, këtu, zjarrin e qilarit,
158. Në qytet kishin vrarë Gjergj Pulën,
159. Prapësirë e madhe që i kishte rënë këtij qyteti,
160. Kur të kthehemi në qytet do ta vrasim Maksutin,
161. Në drejtimin ku ishte qyteti shpërthyen zjarre,

162. Qytet si gjithë të tjetër,
163. Ky s'është qytet,
164. Edhe në qoftë se qyteti do të hidhet në erë me shtëpitë,
165. Tani, gjysmë i braktisur, i ngjashëm me një qytet historik ku jeta ka pushtuar prej kohësh, koracë e gurtë, shkretane, ai priste gjermanët,
166. Qyteti pasi bëri zakonin e qëndresës, priste me qetësi hakmarrjen,
167. Kurrë nuk u mor vesh cili ishte njeriu që u ngjit si fantazmë mbi sipërfaqen e qytetit,
168. Qyteti, pothuaj i braktisur, po pushtohej,
169. Sytë e të gjithëve ishin kthyer në atë drejtim ku duhej të ishte qyteti,
170. Turbull-turbull filluan të skicoheshin trajtat e qytetit,
171. Befas qyteti u ngrit fare pranë nesh.

PËRFUNDIME:

Në përmbyllje të kësaj teme diplome më temë: “Gjuha dhe leksiku në romanin: “Kronikë në gur” te Ismail Kadaresë”, ku përmes kësaj teme jemi përpjekur të bëjmë përshkrimin formal gjuhësor dhe interpretimin e një teknike letrare, që i takon fushës së leksikut, apo hapësirës së ndërmjetme mes gjuhësisë dhe letërsisë. Ne jemi të mendimit se gjuhësia ka një vend të rëndësishëm dhe madje të pazëvendësueshëm brenda studimeve letrare, e posaçërisht në kohët e sotme, kur shprehet gjithnjë e më shumë dyshimi ndaj vlerësimit cilësues të letërsisë. Leksiku, si përmasë historike, dëshmon se për rreth 20 vjet shqipja u pasurua dukshëm në sasi dhe në cilësi.

Sipas studiueses Shefkije Islamaj “Përdorimi i gjuhës, siç dihet, parakupton komunikimin praktik gjuhësor dhe nënshtresën e saj të mendimit, ndërsa si qëllim të vetin kryesor ka lehtësinë dhe arsyeshmërinë e komunikimit, jo gjithmonë është e lehtë të arrihet kjo nga bartësit e gjuhës”¹⁴⁴.

Formimi i imazheve të personazheve realizohet pikërisht përmes imagjinatës, e cila qëndron midis ndjeshmërisë dhe kuptimit. Thelbi i marrëdhënieve që krijohet midis këtyre dy anëve përcakton kufijtë e shtrirjes së imagjinatës sonë në ndërtimin e imazhit. Duke qenë të vetëdijshëm se personazhet e prozës së Kadaresë nuk pasqyrojnë një realitet konkret, pra diçka që ekziston, pra ato nuk janë objekt i perceptimit tonë, ne ndiejmë që edhe imazhi, që krijojmë për to është i një lloji të veçantë.

Gjuha pasqyron një kombësi, ajo është pasqyra më e qartë e një kombësie dhe e kulturës së saj. Shkalla e pasurisë dhe e pastërtisë së gjuhës është një tregues i nivelit të kësaj kulture.

Prirja për përdorimin e leksikut dialektor përbën një nga tiparet e gjuhës së Kadaresë, që shpreh përpjekjet e tij të frytshme për pasurimin dhe njësimin e mëtejshëm të gjuhës letrare shqipe si dhe përgjigjen që ai u dha, me punë e jo me fjalë, të gjithë atyre që e sulmuan në mënyrë asgjësuese shqipen letrare me mëtimin se ajo është një toskërishte letrare të krijuar në mënyrë të pamërituar dhe në kurriz të gegërishtes, me mëtimin se kjo toskërishte letrare është e mbyllur ndaj elementeve të gegërishtes.

Filozofia, mendësia dhe traditat historike e kulturore të shqiptarëve, janë paraqitur në veprën e Kadaresë si shprehje e identitetit të fortë kombëtar, e vitalitetit të kulturës shpirtërore të popullit të vet dhe si faktor i qëndrësës dhe i mbijetesës së tij. Krijues me një vetëdije të fortë kritike, Kadareja jo vetëm ka poetizuar vlerat shpirtërore të kombit të vet, por edhe ka fshikulluar traditat anakronike, mentalitetet e kohës, psikologjinë provinciale dhe konvencionet e jetës së shoqërisë shqiptare. Vepra e Kadaresë është një kërkim i vazhdueshëm. Këto kërkime nxitën zhvillimin e prozës dhe të romanit refleksiv filozofik, jo në kuptimin e ngushtë të fjalës, por në kuptimin e romanit, indin e të

¹⁴⁴ Shefkije Islamaj, *Gjergj Fishta, gjuha dhe stili*, II, Prishtinë, 2012, f. 270.

cilit e formon mendimi për ngjarjet, filozofia e tyre dhe e historisë. Me Kadarenë erdhi në letërsinë shqipe një tip i ri proze, ku elementi narrativ, dhe aq më shumë ai deskriptiv, tërhiqet përpara forcës sugjестive të fjalës, të detajit e të figurës artistike.

Gjuha e Kadaresë shquhet për veçori të shumta pothuaj në të gjitha fushat, në fjalësin, në fjalëformimin, në ndërtimin e togfjalëshave.

Shumica e studimeve leksikore, por duke përfshirë edhe gjuhën e përdorur në aspektin e studimit të saj kanë që qëllim jo vetëm thjesht t'i përshkruajnë veçoritë formale të tekstit si synim në vetvete, por edhe ta nxjerrin në pah domethënien e tyre funksionale për interpretimin e këtij teksti, siç është rasti ynë në lidhje me romanin e Ismail Kadaresë *Kroninë në gur*.

E kemi zgjedhur romanin për ta bërë objekt studimi në këtë temë diplome, sepse, ai bërë forma dominante letrare në shumicën e shoqërive, si në sasi leximi-konsumimi, apo në reagim dhe ndjeshmëri ndaj ndryshimeve kulturore.

Përsa i përket metodave të studimit që kemi përdorur në trajtimin e kësaj teme janë disa, duke filluar nga metoda biografike, metoda sociologjike, dhe metoda e krahasimit gjithashtu.

Metoda e parë na ndihmon, që përmes të dhënave të jetës së autorit dhe formimit të tij, të zbulojmë se pse ka shkruar kaq shumë për gjuhën, për qytetin, për magjitë, për kulturën e qytetit të gurit dhe për fëmijërinë. Ndërsa metoda sociologjike na bën të ditur se përmes të dhënave dhe faktorëve historikë, kulturorë dhe social e kanë çuar Ismail Kadare në formimin veprës më të rëndësishme të rinisë së tij. Për të përfunduar këtë punim kemi përdorur herë njëherë dhe herë tjetër metodë studimi. Duke përdorur herë njëherë dhe herë tjetër kemi arritur në përfundimet e kësaj teme diplome.

Në këtë analizë dhe studim të romanit *Kronikë në gur*, personazhi kryesisht kryen aktivitete fizike të lëvizjes, e percepton botën rreth tij si përvojë të të parit dhe të dëgjuarit, pa qenë në gjendje të ndikojë apo të veprojë në mjedisin që e rrethon, madje deri në masë të skajshme.

Mund të shohim se edhe gjatë përshkrimit të gjendjes emotive, gjuha e rrëfyesit pretendon objektivitet, me fjalët tëhuajuese madje edhe në raport me emrin që shënon gjendje mendore.

Mund të themi se gjuha që i rrëfen ëndrrat dhe ndjesitë apo ligjërimin e brendshëm të këtij personazhi të romanit *Kronikë në gur*, pra gjendet jo doemos plotësisht gjuhësore, shfaqet e distancuar, duke përdorur për shembull strukturën sipërfaqësore sintaktike si përngjasim të ligjërimin të brendshëm apo fillimin dhe mbarim e natyrshëm të ëndrrës, si transmetim besnik të përjetimit.

Mund të themi se përdorimi i formës dialektore në këtë rrëfim është në përputhje me përdorimin e elementeve të tjera gjuhësore që i shfrytëzon rrëfyesi për ta portretizuar personazhin. Rrëfyesi i shmanget kësaj forme atëherë kur transmetohen gjendje emotive dhe joverbale të ndërdijes të

personazhit, dhe e përdor këtë formë në ligjëratën e drejtë të lirë të insertuar në përjetimet e personazhit. Rrëfyeti gradualisht, me zërin e vet e përshkruan ndër dijen e figurshme pothuaj në prag të artikulimit të saj verbal, që të alternojë hap pas hapi nga gjuha e vet në gjuhën e personazhit e të arrijë kulmin me artikulimin e botës së brendshme me vetë idiolektin e personazhit. Të rëndësishme parësore gjithnjë ngelin treguesit tipikë të vokalizimit të brendshëm të personazhit, në radhë të parë kohezioni sintaktik, leksik, semantik dhe tingullor.

Më këto përzgjedhje gjuhësore, rrëfyeti e transmeton mesazhin se nuk pretendon njohuri të privilegjuar për gjendjen shpirtërore të personazhit, ai nuk thotë për shembull 'im atë ndjehej sikur', por e merr pozicionin e atij që vëren nga jashtë personazhit, duke e lënë personazhin lokalizues të plotë, edhe pse idiolekti është plotësisht i rrëfyetit. Toni lirik i përshkrimit të gjendjes shpirtërore nuk është shenjë e stilit simbolik a romantik të autorit, por shenjë e gjendjes së brendshme të personazhit, është teknikë për realizëm psikologjik. Rrëfyeti e arrin tonin ironik me shpërputhjen mes tensionit emotiv të personazhit dhe banalitetit të situatës-faktit që edhe pse femra e tij e idealizuar dhe e ëndërruar pas shumë kohe më në fund është njëqind për qind në dispozicion të tij, mendësisë kolektive totalitare. Megjithëse situata me tërë vrazhdësinë e saj e trondit personazhin, ai arrin ta shprehë me fjalë brendësinë e vet për herë të parë në roman, dhe ligjërimi me idiolektin e tij është shumë i fuqishëm brenda kornizave të përshkrimit figurativ të gjendjes së tij psikike.

Letërsia ndikon ndjeshëm gjuhësisht në mjedisin shoqëror. Lexuesi njihet përmes saj pasurinë e jashtëzakonshme sidomos në leksik dhe në sintaksë. Shkrimtarët, si mjeshtër të fjalës, me artin e tyre kanë dhënë ndihmesë të jashtëzakonshme për ta ngritur gjuhën tonë letrare në shkallën e gjuhëve më të përparuara, e kanë rritur ndjeshëm aftësinë dhe forcën e saj shprehëse. Gjuha e letërsisë artistike si një nga format e shfaqjes së gjuhës kombëtare, duhet të jetë më afër nxënësit dhe ai të modelojë sa më shumë të folurit përmes kësaj gjuhe. Dihet tashmë sesi diferencohet në komunikim dikush që lexon dhe di të lexojë letërsi artistike.

Përsosja e mëtejshme e shqipes sonë letrare, kërkon përpjekje të gjithë njerëzit e penës e në radhë të parë nga shkrimtarët tanë, që ta pasurojnë atë vazhdimisht jo vetëm me fjalë e me shprehje të bukura të të folmeve popullore të Veriut dhe të Jugut, por edhe me fjalë të krijuara sipas gjedheve të fjalëformimit të gjuhës shqipe.

Mjetet e letërsisë, duke qenë një krijim i lirë shkrimtarësh, janë çdo pakti të detyrueshëm me lexuesit, janë të afta t'i rikthejmë mendimit dhe gjuhës atë frymë vetjake njerëzore, që humbi, më saktë u flijua, gjatë procesit dramatik.

Për lexuesin modern, dyshimi në mundësinë e rrëfimit, dyshimi se mund të flasësh, jo vetëm për dikë, por edhe si dikush tjetër do të ishte dyshim dhe krizë e skajshme e identitetit. Në një botë ku nëpërmjet teknologjisë virtualiteti është metafora supreme dhe dominante, funksioni kulturor dhe

raporti i letërsisë me llojet e tjerë të gjuhës është i vetëkuptueshëm. Prezantimi i vetëdijes është dallim radikal nga gjuha e të folurit të përditshëm, dhe ndoshta i zbulon funksionet e gjuhës që më shumë i përshtaten qëllimit të fiksonit, por që në të folurit e përditshëm dominohen nga funksioni komunikativ.

Në romanin *Kronikë në gur* edhe pse personazhet vazhdojnë të sillen si të gjithë njerëzit e tjerë e t'i ruajnë mendimet për vete, lexuesi e krijon ndjenjën se ka njohuri të dorës së parë për personazhin, se ka depërtuar në brendësinë e mendimeve të tij.

Shkrimtari është i lirë që, ashtu siç zgjedh gjininë, llojin, përmbajtjen, personazhet, të zgjedhë edhe gjuhën. Askush nuk ka të drejtë t'i thotë atij të jetë shkrimtar mbarëkombëtar a shkrimtar dialektor. Ismail Kadare i shfrytëzon disa teknika të monologut të brendshëm: monologun e cituar, dekronologjizimin asociativ, kujtesën e rrëfyer dhe monologun e kujtesës, herë si teknika të veçanta e herë të ndërlidhura me njëra-tjetrën. Tiparet gjuhësore të këtyre teknikave arrijnë një efekt të caktuar letrar dhe i kontribuojnë domethënies të përgjithshme të veprës. Konteksti rrëfyes i këtij romani i përshtatet natyrshëm teknikës të monologut të brendshëm në vetën e parë, meqë prezantohen shënimet personale të personazhit, të bazuara në rrëfimin e tij të kujtesës.

Kadareja në romanin e tij *Kronikë në gur* para së gjithash ka dashur të na japë mishin e butë të jetës nën koracën e gurit. Për të qyteti s'është vetëm një koncept arkitektural dhe urbanistik. Një qytet ta banorë, në vetvete, s'ka kuptim. Në marrëdhëniet e figurës së goditur të "mishit të butë të jetës nën koracën e gurit" shkrimtari ka dashur të theksojë se edhe në kohëra të vështira të jetës simbolika e tij është e madhe.

BIBLIOGRAFIA:

Ajeti, Idriz, & Lafe, Emil, *Njëzet e pesë vjet nga kongresi i Drejshkrimit*, në: "Studime filologjike", nr. 12, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1998.

Anxhaku, Besnik, Ismail Kadare në qytetin e gurtë, Pakti midis shkrimtarit dhe vendlindjes, në gazetën: "Albania", e martë, 8 maj, 2001.

Bulo, Jorgo, *Ardhja e Kadaresë në prozën shqipe*, në revistën: "Filologji", nr. 5, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë, 1998.

Çabej, Eqrem, *Për pastërtinë e gjuhës*, në revistën: "Gjuha shqipe", nr. 2/2008, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2008.

Çiraku, Ymer, *Në zbërthim të kodeve letrare*, Toena, Tiranë, 1998.

Dado, Floresha, *Intuitë dhe vetëdije kritike*, Onufri, Tiranë, 2006.

Demiraj, Shaban, *Roli i shkrimtarëve për zhvillimin e shqipes letrare në të kaluarën dhe sot*, në: "Letërsia shqip dhe gjuha letrare", Prishtinë, 1998.

Frojd, Sigmund, *Psikanaliza e artit dhe e letërsisë*, Dituria, Tiranë, 2000.

Islamaj, Shefkije, *Gjergj Fishta, gjuha dhe stili*, II, Prishtinë, 2012.

Isufaj, Viola, *Qyteti dhe qytetërimi në vepra të Kadaresë*, në: "Letërsia dhe qyteti", Tiranë, 2009.

Kadare, Ismail, *Kronikë në gur*, Onufri, Tiranë, 2005.

Kadare, Ismail, *Mosmarrëveshja, mbi raportet e Shqipërisë me vetveten*, Onufri, Tiranë, 2010, f. 98-99.

Kuçuku, Bashkim, *Pas eklipsit letrar*, Botimet Toena, Tiranë, 2014.

Martini, Xhafer, *Jeta në gjerësi dhe thellësi*, revista: "Nëntori", 18 korrik, 1971.

Mato, Jakup, *Kronikë në gur dhe disa tendenca të romanit tonë*, revista: "Nëntori", nr. 7, korrik, 1972.

Memisha, Valter, *Studime për fjalën shqipe II*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2015.

Qosja, Rexhep, *Letërsia shqipe dhe gjuha letrare*, në: "Letërsia shqipe dhe gjuha letrare", Prishtinë, 1998.

Sinani, Shaban, *Historia e letërsisë shqipe-Çështje të hapura*, Naimi, Tiranë, 2015.

Sotiri, Natasha, *Fjalor i gjuhës së Ismail Kadaresë, shenjues i një gjendjeje të re të gjuhës shqipe*, në revistën: "Gjuha Shqipe", nr. 2/2008, Prishtinë, 2008, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2008.

Tahiri, Lindita, *Monologu personazhi dhe autori*, Kosova PEN Center, Prishtinë, 2006.

Xhiku, Ali, *Letërsia shqipe si polifoni*, Tiranë, 2004.

Zeço, Moikom, *Shënime për rromanin "Kronikë në gur"*, në: "Zëri i rinisë", e shtunë, 8 janar, 1972.